

TETOR 2022 | Nr. 20

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
[@ILD_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)

**REFORMA NË DREJTËSI SI FUQI TRANSFORMUESE PËR SHQIPËRINË
DREJT VLERAVE DHE STANDARDEVE EUROPIANE**



ILD
INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË



EFORMA NË DREJTËSI SI FUQI TRANSFORMUESE PËR SHQIPËRINË DREJT VLERAVE DHE STANDARDEVE EUROPIANE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani priti në një takim punë ambasadorën e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Znj. Christiane Hohmann.

Duke e uruar për detyrën në vendin tonë, Z. Metani vlerësoi ndihmën e dhënë nga Bashkimi Evropian për Zyrën e ILD-së, si asistencën teknike përmes misionit EURALIUS V, për konsolidimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, ashtu

edhe rritjen e kapaciteteve përmes CEPEJ, programit për Forcimin e Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Metani i bëri një prezantim të punës e rezultateve të zyrës së ILD-së në këto 2 vite e gjysmë, duke nënvizuar se në punën e saj për verifikimin e shkeljeve

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Metani i bëri një prezantim të punës e rezultateve të zyrës së ILD-së në këto 2 vite e gjysmë, duke nënvizuar se në punën e saj për verifikimin e shkeljeve disiplinore të magjistratëve, ILD-ja udhëhiqet nga parimi i ruajtjes së balancës mes interesit publik për administrimin e drejtësisë nga njëra anë dhe pavarësisë së magjistratëve nga ana tjetër.



disiplinore të magistratëve, ILD-ja udhëhiqet nga parimi i ruajtjes së balancës mes interesit publik për administrimin e drejtësisë nga njëra anë dhe pavarësisë së magistratëve nga ana tjetër.

Ambasadorja Znj. Hohmann vlerësoi rezultatet e arritura nga ILD në dy vite dhe theksoi se Bashkimi European do vazhdojë të mbështesë institucionet e drejtësisë në Shqipëri.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Metani dhe ambasadorja e BE-së, Znj. Hohmann bashkëndanë mendimin se fuqia transformuese e reformës në drejtësi do ndikojë edhe tek mentaliteti shoqëror dhe se procesi i negocimit për anëtarësim nuk do jetë thjesht një proces monitorimi, por bashkëpunimi për zhvillimin, konsolidimin dhe afrimin e Shqipërisë tek vlerat e standardet europiane.

Z. Metani vlerësoi ndihmën e dhënë nga Bashkimi Evropian për Zyrën e ILD-së, si asistencën teknike përmes misionit EURALIUS V, për konsolidimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, Ambasadorja Znj. Hohmann vlerësoi rezultatet e arritura nga ILD në dy vite dhe theksoi se Bashkimi European do vazhdojë të mbështesë institucionet e drejtësisë në Shqipëri.



PUNA E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË NUK MUND TË KRITIKOHET APO LAVDËROHET PA INDIKATORË MATËS

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dha një intervistë për gazetaren Sonila Agostini në Radio Televizionin Shqiptar. Z. Metani foli së pari për bilancin e ILD-së, në raport me pritshmëritë e njohura të publikut edhe për institucionin që drejton, njëlloj si për institucionet e tjera të dala nga reforma në drejtësi.

Ç'ka konstaton tek puna e ILD është interesimi i qytetarëve për t'u drejtuar në institucion për ankesat ndaj magjistratëve.

“Është shumë e vështirë sot të thuash sa rezultate ka pasur, sepse edhe si qytetarë, ne i shikojmë problematikat që ka sistemi, por e rëndësishme është që sot qytetarët janë të ndërgjegjësuar, që ka një sistem që funksionon, për ankesat që ata kanë

ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky është hapi parë mendoj unë, i ndërgjegjësimit se ka një institucion, ka një mekanizëm, që u kthen përgjigje shqetësimeve të tyre.”, tha z. Metani.

Në lidhje me procesin e punës së ILD-së, me afatet ligjore për trajtimin e një anese, 3, 6 e 9 muaj, tek kapacitetet në burime njerëzore në raport me numrin prej afro 5 mijë ankesash të depozituara, z. Metani tha se Inspektori i Lartë i Drejtësisë e ka ndjeshmërinë ndaj pakënaqësisë e padurimit që kanë qytetarët për trajtimin me shpejtësi të ankesave të tyre.

Për këtë është miratuar një metodologji pune, e publikuar në faqen zyrtare të

“Është shumë e vështirë sot të thuash sa rezultate ka pasur, sepse edhe si qytetarë, ne i shikojmë problematikat që ka sistemi, por e rëndësishme është që sot qytetarët janë të ndërgjegjësuar, që ka një sistem që funksionon, për ankesat që ata kanë ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky është hapi parë mendoj unë, i ndërgjegjësimit se ka një institucion, ka një mekanizëm, që u kthen përgjigje shqetësimeve të tyre.”

internetit, sipas të cilës, ankesat e hershme, ato që ILD i ka trashëguar nga ish KLD e KLGJ, të trajtohen me prioritet, në mënyrë që të shmanget me sa është e mundur tejkalimi i afateve të shqyrtimit të tyre, pasi ka qytetarë që presin prej vitesh një përgjigje për ankesat që kanë bërë në institucione të tjera.

“Padyshim që ka pasur ankesa, sepse sot që ne po flasim, numri i ankesave që gjenden të depozituara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është afro 5 mijë, diçka më pak, por e rrumbullakosur 5 mijë.

Numri i ankesave të trajtuara është gjysma.

Natyrisht gjysma është e pakënaqur sepse pret përgjigje, por Zyra e ILD-së është përpjekur të jetë transparente me mënyrën se si i trajton ankesat e qytetarit. Sot në faqen e internetit të Zyrës së ILD-së është publikuar metodologjia se si punon Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pra cilave ankesave u jep prioritet, si i trajton këto ankesa, afatet brenda të cilave ai i trajton, në mënyrë që qytetarët, përpara se të kenë një pakënaqësi, aq sa mundet, se

padyshim se qytetarët nuk mund të jenë të gjithë juristë, ta shikojnë se ne mundohemi të jemi sa më shumë transparentë me ta, në mënyrë që qytetarët të kuptojnë se si ne punojmë.

Në këtë mënyrë ata janë të lirë të vlerësojnë punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ka pakënaqësi me thënë të drejtën, sepse këtë e shikojmë edhe tek ankesat e përsëritura që vijnë. Mundohemi të adresojmë në kohë çdo shqetësim. Por prioritet kanë pasur ankesat e vjetra, sepse duhet t’u kthejmë një përgjigje qytetarëve, që me kohë i ishin drejtuar zyrave të shtetit, dhe të mos harrojmë më pas edhe ankesat që kanë paraqitur qytetarët së fundmi.”

Pyetjes, nëse në 2 vite e gjysmë në detyrë ka patur ndërhyrje apo presion nga politika, z. Metani iu përgjigj:

“Unë mendoj, që pyetja e rëndësishme nuk është a ka presion. Pyetja më e rëndësishme është a ndikohemi ne nga ky presion dhe a i nënshtrohemi këtij



presioni, ne institucionet e reja të drejtësisë, por edhe gjykatat dhe prokuroritë.

Përgjigja personale është jo! Nuk ka shans që ky institucion t'i nënshtrohet presionit politik, apo çfarëdo lloj presioni tjetër, sepse nuk ka vetëm presion politik. Këtu duhet të jemi të qartë për këtë gjë, ne edhe të gjithë të tjerët. Jam i bindur, që edhe kolegët mendojnë dhe kanë të njëjtën përgjigje.”

I pyetur nëse mendon se 6 vite pas miratimit të reformës në drejtësi duhet të ketë një proces monitorues për të matur rezultatet apo dështimet e reformës në drejtësi, Metani tha se tashmë ky është një proces i nevojshëm edhe pse delikat dhe ky proces mund të bëhet nga Kuvendi i Shqipërisë.

“Vlerësimi i institucioneve të drejtësisë është delikat, jo thjesht për ata që janë sot në institucionet e drejtësisë, qoftë edhe personalisht. Është e rëndësishme që puna e gjykatave dhe prokurorisë, puna e institucioneve të drejtësisë, të matet me tregues analitikë dhe shkencorë.

Nuk matet dot me perceptime në këndvështrimin tim. Pra nuk mund të kritikohet pa indikatorë dhe pa tregues puna e institucioneve të drejtësisë, ashtu siç nuk mund të lavdërohet pa indikatorë.

Për mua e rëndësishme është që puna të vlerësohet me standarde, dhe nëse janë vendosur standarde nga këto institucione, nga ILD, KLGJ, KLP nga KPA, për procedimet disiplinore që kemi, e vlerësojmë dhe pastaj shohim çfarë duhet ndryshuar.



INSPEKTORË TË RINJ JOMAGJISTRATË NISIN PUNË PRANË ILD-SË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Z. Artur Metani mirëpriti inspektorët e rinj jomagjistratë, që i bashkohen Njesisë së Inspektorëve pranë ILD-së.

Në përfundim të procedurave disa mujore të konkurimit e përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit, katër kandidatët që kanë marrë më shumë pikë do jenë pjesë e ILD-së.

Duke u uruar mirëseardhjen në institucion, Z. Metani nënvizoi rëndësinë që ka plotësimi i trupës së inspektorëve, në kushtet kur numri i ankesave ndaj gjyqtarëve e prokurorëve është tejet i lartë në raport me kapacitetet e ILD-së.

“Siç dihet, tha Inspektori i Lartë i Drejtësisë, këtë vit kemi përcaktuar si prioritet uljen e fondit të dosjeve të

trashëguara nga institucione të tjera, krahas trajtimit të ankesave që i janë drejtuar ILD-së në 2 vite e gjysëm aktivitet, si dhe inspektimet tematike, një dimension i rëndësishëm i punës së institucionit.

Po punohet me ritëm të lartë dhe i jemi mirënjohës çdo qytetari për durimin, pasi në kushtet e një ngarkese të tillë, afatet e trajtimit të ankesave janë të lidhura me kapacitetet e institucionit.”

Janë rreth 5 mijë ankesa të konfirmuara në ILD, të trashëguara dhe të ardhura direkt në institucion.

Me inspektorët e rinj jomagjistratë, Njësia e Inspektorëve numëron 12 Inspektorë magjistratë dhe jo magjistratë, nga 26 të tillë të parashikuar në organikë.

SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE



Gjatë asistimit të ankuesve

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-

14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

*Gjatë muajit **Tetor 2022**, Sektori i Ndhmës Juridike dhe Ankesave ka pritur **31 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe **22 telefonata me qytetarë**, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.*



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas ligjit dhe komunikon me kërkuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik. Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Tetor, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 14 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t'i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë

në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

TETORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Tetor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **60 ankesa**, **58** nga të cilat janë paraqitur nga qytetarët dhe **2 ankesa** nga institucione.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Tetor** 2022. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME

- 9 vendime verifikimi, nga të cilat:
- 6 vendime verifikimi, shqyrtim fillestar (ILD);
- 3 vendime verifikimi, shqyrtim fillestar (dosje të mbartura nga ish KLD);
- 3 vendime vijim verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);

HETIME DISIPLINORE

- 2 vendime për fillim hetimi disiplinor për 2 magjistrat;
- 1 vendim për vazhdim të hetimit disiplinor
- 4 vendim mbyllje hetimi disiplinor për 7 magjistratë
- 1 kërkesë për procedim disiplinor për 1 magjistrat

ARKIVIME

72 vendime arkivimi nga 95 praktika të shqyrtuara:


- 33 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (ILD);
 - 13 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar (dosje të mbartura nga ish KLD);
- 26 vendime arkivimi pas verifikimit, nga të cilat :
- 15 vendime arkivimi pas verifikimit (ILD);
 - 11 vendime arkivimi pas verifikimit (dosje të mbartura nga ish KLD).

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit Tetor, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, nga ankues, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuara prej tyre.

Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.

Gjatë muajit Tetor 2022, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë 30 shpallje publike, ndërsa gjatë muajit Shtator 75.



ANKETA- DUAM MENDIMIN TUAJ PËR ILD-NË

Komunikimi me publikun në funksion të transparencës mbetet një prioritet i vazhdueshëm për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Për të rritur komunikimin me qytetarët, Zyra e ILD ka hartuar dhe publikuar në faqen e internetit një Anketë, përmes së cilës kërkohet mendim mbi punën e deritanishme të institucionit. Anketa mund të plotësohet online ose fizikisht pranë ILD-së.



BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETET SI DIMENSION I RËNDËSISHËM I VIZIONIT TË ILD-SË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani zhvilloi një takim pune me rektorët e Universiteteve publike, respektivisht me Prof. Dr. Artan Hoxha, i Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Skënder Topi, i Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, Prof. Dr. Suzana Golemi, e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Prof. Dr. Kseanela Sotirofski, e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës dhe Prof. Roland Zisi, i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.

Takimi kishte në fokus vullnetin për vendosjen e urave të bashkëpunimit konkret, në funksion të përgatitjes së studentëve me praktikën e punës dhe funksioneve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si një nga institucionet e reja të reformës në drejtësi, përgjegjës për trajtimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore, fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, si dhe inspektimin institucional të zyrave të prokurorive e gjykatave.

Metani dhe rektorët bashkëndanë mendimin se zhvillimi profesional, fillestar dhe i vazhdueshëm i studentëve do jetë një ndihmesë e jashtëzakonshme, si në mbështetje të kurrikuluës arsimore, ashtu edhe për zhvillimin e kapaciteteve të studentëve me praktikën e punës së ILD-së.


Gjatë bashkëbisedimit u identifikuan disa mënyra bashkëpunimi, si përmes leksioneve të hapura në universitete nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe përfaqësues të tjerë të institucionit,

përmes praktikave mësimore të studentëve pranë ILD-së, si dhe një bashkëpunimi më të gjerë e në vijimësi, përmes projekteve të përbashkëta e aktiviteteve të ndryshme në fusha me interes të përbashkët.

Bashkëpunimi i ILD-së me universitetet e Tiranës, Elbasanit, Shkodrës, Durrësit dhe Vlorës do formalizohet së shpejti me marrëveshje konkrete bashkëpunimi, ku do përcaktohen modalitetet për zbatimin e ideve të diskutuara në këtë takim pune.

Bashkëpunimi i ILD-së me universitetet e Tiranës, Elbasanit, Shkodrës, Durrësit dhe Vlorës do formalizohet së shpejti me marrëveshje konkrete bashkëpunimi, ku do përcaktohen modalitetet për zbatimin e ideve të diskutuara në këtë takim pune.

ANKESAT NË ILD





NË SHQIPËRI E KOSOVË DREJTËSIA DUHET PARË SI NJË VLERË SHOQËRORE

Në kuadër të vizitës së punës në Kosovë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani ka zhvilluar disa takime me institucionet e drejtësisë në Prishtinë.

Në takimet me Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Jetish Maloku dhe Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Blerim Isufaj, e më pas me kryetarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të Kosovës, z. Albert Zogaj, u diskutua mbi mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve respektive dhe u shpreh vullneti për shkëmbim eksperiencash.

Gjatë këtyre takimeve, në përgjigje të interesit për reformën në drejtësi në Shqipëri, z. Metani e vuri theksin tek rëndësia e ndarjes dhe e balancimit të pushteteve, tek

mentaliteti i ri që duhet të sjellë reforma, e cila ndër të tjera duhet të shërbejë për të zhvilluar shoqërinë demokratikisht dhe të kultivojë të drejtën si vlerë kulturore.





Sfidat e dy vendeve lidhur me sistemin e drejtësisë u diskutuan edhe në takim që Inspektori i Lartë i Drejtësisë pati me ministren e Drejtësisë së Kosovës, znj. Albulena Haxhiu. Të dy bashkëbiseduesit ndanë qëndrimin e njëjtë, se drejtësia është pikësëpari një vlerë shoqërore, e se në këtë kuadër, shoqëria si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, duhet të përpiqet të përshtaten me këtë vlerë. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet edukimit dhe qasjes ndaj një

mentaliteti të ri të shoqërisë, që lidhet me zbatimin e ligjit dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës, u tha në takim.

Duke qenë se Kosova është në pikënisje të një reforme në sistemin e drejtësisë, z. Metani dhe znj. Haxhiu bashkëndanë qëndrimin se me përpjekjen e përbashkët të dy vendeve, duhet të ngrihen procese bashkëpunimi dhe ndërveprimi për të mësuar nga eksperiencia shqiptare.





ILD MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ME FAKULTETIN JURIDIK TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Gjatë një vizite pune që zhvilloi në Kosovë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani u takua me ushtruesen e detyrës së rektorit të universitetit “Hasan Prishtina” të Prishtinës, Prof. Ass. Dr. Luljeta Plakolli-Kasumi dhe nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Fakultetin Juridik të këtij universiteti, që do të kontribuojë në thellimin e

shkëmbimin e njohurive në fushën e drejtësisë. Gjatë takimeve u shpreh kënaqësia për vendosjen e urave të komunikimit mes Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në Shqipëri dhe universitetit të Prishtinës, për të krijuar mundësi bashkëpunimi, që ndihmojnë të dyja palët të ndërmarrin nisma të përbashkëta.





Pas nënshkrimit të memorandumit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani dhe Dekani i Fakultetit Juridik të universitetit të Prishtinës, Prof. As. Dr. Avni Puka nënvizuan se produkti i parë i kësaj marrëveshjeje do të jetë nisja brenda vitit, e praktikave të studentëve të Fakultetit Juridik pranë Zyrës së ILD-së.

Mes të tjerash në memorandumin e

bashkëpunimit mes ILD-së dhe Fakultetit të Drejtësisë së universitetit të Prishtinës, parashikohet shfrytëzimi i kapaciteteve të përbashkëta për ndërtimin e programeve edukuese, që i shërbejnë komunitetit të studentëve, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta në fushën e drejtësisë, përfshirë nisma me karakter akademik e hulumtues, si dhe organizimi i tryezave dhe ligjëratave të ndryshme.





PJESËMARRËSIT E PROGRAMIT LEAD ALBANIA 2021-2022 VIZITË NË ILD

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Z. Artur Metani mikpritri sot në ambientet e ILD-së klasën e vitit 2022 të programit LEAD Albania, të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.

Pjesëmarrësit e programit një vjeçar LEAD Albania, janë profesionistë të rinj e të talentuar, që kanë mundësinë të kenë përvoja të drejtpërdrejta në procesin e qeverisjes,

përmes angazhimit për një vit, si pjesë e kabineteve të institucioneve më të larta shtetërore në vend, që nga Presidenti i Republikës e deri tek Bashkia e Tiranës.

Për herë të parë këtë vit, pjesëmarrës të LEAD Albania janë punësuar edhe në institucionet e reja të drejtësisë, si Inspektori i Lartë i Drejtësisë, që mikpritri znj. Edlira Osmani.





Takimi me Z. Metani u zhvillua në formë bashkëbisedimi mbi rolin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Metani vlerësoi impenjimin e këtyre të rinjve të shkolluar jashtë për të kontribuar për vendin në profesionet e tyre. Në përgjigje të interesit të pjesëmarrësve edhe për perceptimin e publikut ndaj institucionit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Metani nënvizoi se për ILD-në e rëndësishme është që krahas besimit të publikut tek drejtësia, të forcojë edhe besimin e magistratëve tek ILD, në mënyrë që ata të marrin vendime të drejta e të pandikuara në punën e tyre.





INTERVISTË E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË Z. ARTUR METANI DHËNË PËR RADIO TELEVISIONIN SHQIPTAR

Gazetarja Sonila Agostini: Në Shqipëri ditët e tuaj fundit po flitet shumë për reformën në drejtësi, për punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por edhe për presionin e publikut që ka një pritshmëri të lartë. Pikërisht sot për rrjetin e Radio Televizionit Shqiptar po intervistojmë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani, institucioni i të cilit, pas dy vite e gjysëm që ka nisur detyrën për shkak të reformës në drejtësi, ka kërkuar disa ndryshime në ligjet bazë të kësaj reforme, por edhe për të kuptuar më shumë se si kontrollohen prokurorët dhe gjyqtarët në Republikën e Shqipërisë. Zoti Metani përshëndetje! Faleminderit për këtë intervistë për rrjetin e Radio Televizionit Shqiptar.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani: Përshëndetje! Faleminderit për vizitën

Gazetarja Sonila Agostini: Pas dy viteve e gjysëm që ju jeni në krye të këtij institucioni të ri të reformës në drejtësi, a keni një bilanc për publikun, që vetë e keni thënë në krye të herës se ka patur shumë pritshmëri, jo vetëm për ju, hapi parë mendoj unë, i ndërgjegjësimit se ka një institucion, ka një mekanizëm, që u kthen përgjigje shqetësimeve të tyre.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani: Reforma në drejtësi u ideua, konceptua dhe miratua për shkak të disa nevojave emergjente, që po paraqiste sistemi në atë kohë, si për shkak të organizimit, të procedurave, por më së shumti për shkak të besimit publik në rënie në atë kohë, ndaj sistemit të drejtësisë. Natyrisht institucionet e reja,

që u krijuan u përballën fillimisht me këtë sfidë të jashtëzakonshme, rritja apo kthimi i besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë. Kjo ishte edhe deviza apo qëllimi kryesor i punëve të para, që zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bëri që në momentin që u emërua Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Është një sfidë shumë e vështirë. Është shumë e vështirë, sepse nga njëra anë duhet të përballosh presionin, me të drejtë të publikut për rezultate në punën e drejtësisë, rezultate për punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për vendime të drejta, të dhëna në zbatim e në përputhje me ligjin. Padyshim që interesi i publikut dhe kujdo, edhe i institucioneve të tjera për punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve në administrimin e institucioneve të drejtësisë është legjitim. Nga ana tjetër kemi një interes po kaq të rëndësishëm, kemi një parim po kaq të rëndësishëm, siç është parimi i ndarjes së pushteteve apo parimi i pavarësisë së gjyqtarëve e prokurorëve. Ky parim nuk është një mjet për të mbrojtur gjyqtarët dhe prokurorët, por është një mjet për të përballuar këto balanca të rëndësishme në shoqëri, sepse këto balanca, apo kjo mbrojtje që u bëhet gjyqtarëve dhe prokurorëve është në fakt mbrojtje për shoqërinë. Sepse një gjyqtar që është i pavarur në vendimmarrjen e vet, është i pavarur për këdo, për çdo qytetar, për çdo institucion, që ka nesër një çështje përpara gjykatave dhe prokurorisë. Duke pasur këtë filozofi në mendje, jemi përpjekur shumë dhe besoj se sot flasim për rezultate të tjera në këtë drejtim, pra pritshmërive që publiku ka patur ndaj institucionit tonë të paktën, apo ndaj sistemit në tërësi. Është shumë e vështirë sot të thuash sa rezultate ka pasur, sepse edhe si qytetarë, ne i shikojmë problematikat që ka sistemi, por e rëndësishme është që sot qytetarët janë të ndërgjegësuar, që ka një sistem që funksionon, për ankesat që ata ka-

në ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky është hapi parë mendoj unë, i ndërgjegjësimit se ka një institucion, ka një mekanizëm, që u kthen përgjigje shqetësimeve të tyre.

Gazetarja Sonila Agostini: Sa kohë i duhet një inspektori të zyrës tuaj, për të hetuar një gjyqtarë apo prokurorë, që nga momenti që paraqitet një kërkesë nga publiku?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani: Në kuptimin strikt ligjor afati i hetimit, i trajtimit të një ankese fillon nga tre muaj, që është trajtimi fillestar, pra konfirmimi, shqyrtimi, arkivimi ose verifikimi fillestar i ankesës. Nëse pas këtij afati, ILD vlerëson se ankesa duhet të shkojë në verifikim të mëtejshëm, pra është një tjetër fazë procedurale, apo më tej, në një tjetër fazë ligjore, të shkojë në hetim, vetë hetimi ka si afat ligjor një periudhë 6 mujore, e në raste të vecanta 9 muaj, në varësi të kompleksitetit të çështjes. Në përfundim të këtyre afateve Inspektori i Lartë i Drejtësisë është i detyruar të marrë një vendim, ose për pushimin e hetimit ose për dërgimin e çështjes për procedim pranë këshillave përkatës, si Këshilli i Lartë Gjyqësor për gjyqtarët dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për prokurorët.

Gazetarja Sonila Agostini: Mendoni që gjatë këtyre dy viteve e gjysëm, ka pasur pakënaqësi për kohën e hetimit apo shqyrtimit të dosjeve të caktuara?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani: Padyshim që ka pasur ankesa, sepse sot që ne po flasim, numri i ankesave që gjenden të depozituara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është afro 5 mijë, diçka më pak, por e rumbullakosur 5 mijë. Numri i

ankesave të trajtuara është gjysma. Natyrisht gjysma është e pakënaqur sepse pret përgjigje, por Zyra e ILD-së është përpjekur të jetë transparente me mënyrën se si i trajton ankesat e qytetarit. Sot në faqen e internetit të Zyrës së ILD-së, është publikuar metodologjia se si punon Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pra cilave ankesave u jep prioritet, si i trajton këto ankesa, afatet brenda të cilave ai i trajton, në mënyrë që qytetarët, përpara se të kenë një pakënaqësi, aq sa mundet, se padyshim se qytetarët nuk mund të jenë të gjithë juristë, ta shikojnë se ne mundohemi të jemi sa më shumë transparentë me ta, në mënyrë që qytetarët të kuptojnë se si ne punojmë. Në këtë mënyrë ata janë të lirë të vlerësojnë punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ka pakënaqësi me thënë të drejtën, sepse këtë e shikojmë edhe tek ankesat e përsëritura që vijnë. Mundohemi të adresojmë në kohë çdo shqetësim. Por prioritet kanë pasur ankesat e vjetra, sepse duhet t'u kthejmë një përgjigje qytetarëve, që me kohë i ishin drejtuar zyrave të shtetit, dhe të mos harrojmë më pas edhe ankesat

që kanë paraqitur qytetarët së fundmi. Ajo që dua të them për këtë, është ta nënvizoj, se sjellja e një ankese tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk do të thotë në mënyrë absolute, që qytetarët duhet të heqin dorë nga ankimimi i çështjeve në gjykatat më të lartë, në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë. Trajtimi i ankesës nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka ndikim fare në çështjen që ata kanë. Në mënyrën më demokratike të mundshme, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë verifikon dhe trajton ankesat, pasi ka përfunduar gjykimi i çështjes. Sepse trajtohet shkelja e supozuar e magjistratit dhe jo vendimi gjyqësor. Shkelja e natyrës administrative të magjistratit. Pra ne nuk hyjmë në themel apo diskrecion të vendimmarrjes së magjistratit, gjykatës apo prokuror, është shumë e rëndësishme të kuptohet kjo! Ne nuk jemi në kontroll të gjykatave, përse i përket vendimmarrjes së tyre, ne jemi në kontroll të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, nëse ata kanë kryer shkelje procedurale, të cilat padyshim, pasohen me sanksionet që përmban ligji.



Gazetarja Sonila Agostini: Keni kaq kohë që përballeni me një fluks të lartë të kërkesave të publikut për ankesat që ata kanë. Ju jeni një nga institucionet që keni kërkuar ndryshimet të disa ligjeve bazë të reformës në drejtësi të miratuar 6 vite më parë. Me çfarë përballeni dhe pse keni kërkuar ndryshim të ligjit, për shkak të mungesës së kapaciteteve që keni, për shkak të mungesës së inspektorëve, çfarë nuk funksionon me pjesën tuaj nga reforma në drejtësi?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani:

Dua ta them që në fillim, që ndryshimet ligjore që kemi kërkuar janë ndryshime që nuk prekin sistemin. Për mua është shumë e rëndësishme që ta theksoj këtë, sepse ne i besojmë sistemit që është ngritur dhe po funksionon, për aq sa po funksionon, dhe mendoj se i duhet lënë kohë sistemit, të nxjerrë vetë problematikat e veta. Ndryshimet që kemi kërkuar janë ndryshime që i japin mundësi Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të punojë më shpejt. E thënë më konkretisht, inspektorët në Zyrën e ILD-së, vijnë edhe nga fusha e juristëve me eksperiencë, pra që kanë 15 vite eksperiencë pune. Gjysma e trupës së inspektorëve, sipas ligjit duhet të jenë juristë me 15 vite eksperiencë pune dhe gjysma tjetër e inspektorëve janë magjistratë, pra prokurorë ose gjyqtarë, me 13 vite eksperiencë pune. Pra këta duhet të plotësojnë kriteret e një magjistrati të nivelit të anëtarit të Gjykatës së Lartë.

Gazetarja Sonila Agostini: Ku gjenden këta njerëz me 15 vite eksperiencë?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani:

Sot në Zyrën e ILD-së, ka 4 prokurorë të komanduar nga KLP, por nuk ka asnjë gjyqtar të komanduar, pas thirrjeve të bëra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Nga gjashtë apo shtatë thirrje

që ka bërë KLGJ, sipas kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të thithur inspektorë nga rradhët e gjyqtarëve, ka pasur zero aplikime. Nuk ka pasur interes nga gjyqtarët për të aplikuar pranë Zyrës së ILD-së. Kjo e pengon punën, e pengon punën jo vetëm në sasi numrash, por edhe në cilësi, sepse natyra e gjyqtarit ka tjetër profil pune. Është tjetër prurje puna e gjyqtarit në Zyrën e ILD-së. Tek e fundit ne i kemi 4 prokurorë, por na duhet të kemi edhe magjistratë gjyqtarë, për të balancuar dhe analizuar këtë punë që ne bëjmë. Duke qenë se nuk kemi prurje apo nuk kemi aplikime nga gjyqtarë jemi në vështirësi, pasi është shumë e nevojshme që kjo zyrë të ketë gjyqtarë, përpara se sa të ketë inspektorë të profilit tjetër. Prandaj ne kemi propozuar që të rishikohet kriteri 13 vite për inspektorët magjistratë, sepse është kriter që duhet të plotësojë një magjistrat për të qenë anëtar i Gjykatës së Lartë. Të zëvendësohet ai kriter, me atë që kërkohet për t'u bërë gjyqtar apeli, pra shtatë vite.

Gazetarja Sonila Agostini: Nëse zbuten këto kritere të pranimit të inspektorëve në Zyrën e ILD-së, cilat janë valvulat e sigurisë, që performanca e tyre, puna e tyre nuk do të çënohet. Sepse sigurisht një gjyqtar apo një magjistrat me 15 vite eksperiencë është një siguri më shumë për publikun, që është i aftë profesionalisht dhe të ketë një performancë më të madhe. Nëse këto kritere ulen si vitet e pranimit në Zyrën e Inspektorit, a çënohet profesionalizmi i punës mendoni?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani:

Jo nuk mendoj se çënohet profesionalizmi i punës. Nuk është thjesht kriteri statistikor i viteve të eksperiencës së punës, ai që garanton cilësinë e punës. Padyshim që është një element i rëndësishëm, por nga ana tjetër, -

nga analiza që ne kemi bërë është shumë e rëndësishme që standardet që janë vendosur, ose që po vendosen dita – ditës nga Zyra e ILD-së, të konfirmuara edhe nga puna e Këshillave, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të konfirmuara këto edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, për rastet e apelimeve, që ka pasur për procedimin disiplinor të magjistratëve janë një garanci e rëndësishme, se puna e ngritur deri tani, ka vendosur disa standarde të rëndësishme. Më shumë se standardet që ngrihen apo po ngrihen, ka më shumë nevojë për punë.

Gazetarja Sonila Agostini: Kur e keni nisur detyrën, mbaj mend që jeni pyetur nga gazetarët në lidhje me lirin e të fortëve, nëse mund t'i quajmë kështu, nga burgjet shqiptare nga gjyqtarë të caktuar. Në fakt nuk kemi më deklarata, apo ndjeshmërinë që kishte para dy viteve e gjysëm për gjyqtarë që lironin personazhe të botës së nëndheshme. Çfarë ka ndodhur, ka një reflektim nga ana e gjyqtarëve, presioni i reformës në drejtësi, apo presioni i Zyrës tuaj, i ka bërë ata të mendojnë që mund të shkojnë përballë akteve disiplinore. Pse nuk flitet më për lirin e të fortëve?

"Nga zyra e ILD-së nuk ka asnjë presion, në çfarëdo lloj forme apo mënyre mbi punën së gjyqtarëve apo prokurorëve. Presionet e vetme janë standardet, standarde që i ka vendosur ligji në fakt, s'i ka vendosur, as Zyra e ILD-së, as Këshillat, për procedimet që ka çuar ILD. Ajo që shikoj, edhe bashkohem me ju në këtë reflektim është që gjyqtarët dhe prokurorët sot janë më të kujdeshëm dhe hezitojnë, që Institutin që e ka parashikuar ligji në fakt për lirin para kohe me kusht, janë të kujdeshëm në zbatimin e tij. Kjo është ajo që mendoj unë është kontribut i ILD-së dhe i Këshillave. Pra janë standarde që gjyqtarët e prokurorët duhet të jenë të kujdeshëm në zbatimin e disa normave, që në tek e fundit fare janë në ligj."

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani: Nga zyra e ILD-së nuk ka asnjë presion, në çfarëdo lloj forme apo mënyre mbi punën së gjyqtarëve apo prokurorëve. Presionet e vetme janë standardet, standarde që i ka vendosur ligji në fakt, s'i ka vendosur, as Zyra e ILD-së, as Këshillat, për procedimet që ka çuar ILD. Ajo që shikoj, edhe bashkohem me ju në këtë reflektim është që gjyqtarët dhe prokurorët sot janë më të kujdeshëm dhe hezitojnë, që Institutin që e ka parashikuar ligji në fakt për lirin para kohe me kusht, janë të kuj-

deshëm në zbatimin e tij. Kjo është ajo që mendoj unë është kontribut i ILD-së dhe i Këshillave. Pra janë standarde që gjyqtarët e prokurorët duhet të jenë të kujdeshëm në zbatimin e disa normave, që në tek e fundit fare janë në ligj.

Gazetarja Sonila Agostini: Meqë jemi tek kjo pikë, është folur për presione të politikës ndaj sistemit të drejtësisë. Në momentin që reforma në drejtësi u miratua në vitin 2016, vetë sistemi është rregulluar nëpërmjet

një reforme ligjore, që ia ka hequr politikës nga duart mundësinë e zgjedhjes së njerzve në sistemin e drejtësisë. A keni ju sot presion nga politika në punën tuaj? Po ua bëj këtë pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi kjo është pyetja që shqiptarët kanë, se pse nuk hetohet pse nuk vepron. A ka presion politika mbi arkitekturën e re të sistemit të drejtësisë?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani:

Ndërsa unë mendoj, që pyetja e rëndësishme nuk është a ka presion. Pyetja më e rëndësishme është a ndikohemi ne nga ky presion dhe a i nënshtrohemi këtij presioni, ne institucionet e reja të drejtësisë, por edhe gjykatat dhe prokuroritë. Përgjigja personale është jo! Nuk ka shans që ky institucion t'i nënshtrohet presionit politik, apo çfarëdo lloj presioni tjetër, sepse nuk ka vetëm presion politik. Këtu duhet të jemi të qartë për këtë gjë, ne edhe të gjithë të tjerët. Jam i bindur, që edhe kolegët mendojnë dhe kanë të njëjtën përgjigje.

Gazetarja Sonila Agostini: Në këto dy vite e gjysmë a keni pasur ankesa për gjyqtarë të Gjykatës së Posaçme, apo prokurorë të SPAK, në lidhje me performancën e punës së tyre. Ose a ka aktualisht ILD, emra që po heton në lidhje, për shkak të ankesave, që kanë ardhur për gjyqtarë të gjykatës së posaçme apo prokurorë të SPAK?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani:

Në këtë numër të madh ankesash ka edhe ankesa për prokurorë apo gjyqtarë të SPAK-ut. Disa janë trajtuar, disa janë në trajtim e sipër.

Gazetarja Sonila Agostini: Për çfarë ankohen rëndom qytetarët zoti Metani për gjyqtarët dhe prokurorët? Çfarë ju ka rënë më shumë në sy, kur keni shfletuar dosjet dhe ankesat e tyre?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani:

Ajo që i bashkon shumicën e ankesave është zvarritja e proceseve gjyqësore dhe pastaj vendimmarrjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, që janë dhe çështje diskrecioni të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ne jemi munduar ta adresojmë në fakt çështjen e zvarritjeve. Këtu dua të ngre edhe një shqetësim, sepse ajo që po ndodh, edhe për shkak të presionit publik legjitim në fakt, që gjyqtarët të shpejtojnë proceset e tyre të punës, që t'i japin përgjigje publikut për çështjet që ata trajtojnë, vihet re se po bie cilësia e dhënies së drejtësisë, sepse nga nxitimi, shpeshherë vendimet po cedojnë nga standardet dhe natyrisht asnjëra as tjetra s'janë të mira. Gjetja e balancës së përshpejtimin të proceseve gjyqësore dhe dhënies së një vendimi cilësor është procesi i punës që ne bëjmë dhe i verifikojmë dhe i shohim çdo ditë.

"Unë mendoj, që pyetja e rëndësishme nuk është a ka presion. Pyetja më e rëndësishme është a ndikohemi ne nga ky presion dhe a i nënshtrohemi këtij presioni, ne institucionet e reja të drejtësisë, por edhe gjykatat dhe prokuroritë. Përgjigja personale është jo! Nuk ka shans që ky institucion t'i nënshtrohet presionit politik, apo çfarëdo lloj presioni tjetër, sepse nuk ka vetëm presion politik. Këtu duhet të jemi të qartë për këtë gjë, ne edhe të gjithë të tjerët. Jam i bindur, që edhe kolegët mendojnë dhe kanë të njëjtën përgjigje."

"Sot që ne po flasim, numri i ankesave që gjenden të depozituara në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është afro 5 mijë, diçka më pak, por e rrumbullakosur 5 mijë. Numri i ankesave të trajtuara është gjysma. Natyrisht gjysma është e pakënaqur sepse pret përgjigje, por Zyra e ILD-së është përpjekur të jetë transparente me mënyrën se si i trajton ankesat e qytetarit. Sot në faqen e internetit të Zyrës së ILD-së është publikuar metodologjia se si punon Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pra cilave ankesave u jep prioritet, si i trajton këto ankesa, afatet brenda të cilave ai i trajton, në mënyrë që qytetarët, përpara se të kenë një pakënaqësi, aq sa mundet, se padyshim se qytetarët nuk mund të jenë të gjithë juristë, ta shikojnë se ne mundohemi të jemi sa më shumë transparentë me ta, në mënyrë që qytetarët të kuptojnë se si ne punojmë."

Gazetarja Sonila Agostini: A mendoni se pas 6 vitesh të miratimit të reformës në drejtësi, duhet të ketë një proces monitorues, për të matur rezultatet apo dështimet e reformës në drejtësi? Kjo është pyetja e fundit që kam.

KLJG, KLP nga KPA, për procedimet disiplinore që kemi, e vlerësojmë dhe pastaj shohim çfarë duhet ndryshuar. Por ndryshimi duhet të vijë në bazë të një studimi dhe analize profesionale.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani: Faleminderit për pyetjen. Është pyetje shumë e rëndësishme sepse vlerësimi i institucioneve të drejtësisë është delikat, jo thjesht për ata që janë sot në institucionet e drejtësisë, qoftë edhe personalisht. Është e rëndësishme që puna e gjykatave dhe prokurorisë, puna e institucioneve të drejtësisë, të matet me tregues analitikë dhe shkencorë. Nuk matet dot me perceptime në këndvështrimin tim. Pra nuk mund të kritikohet pa indikatorë dhe pa tregues puna e institucioneve të drejtësisë, ashtu siç nuk mund të lavdërohet pa indikatorë. Për mua e rëndësishme është që puna të vlerësohet me standarde, dhe nëse janë vendosur standarde nga këto institucione, nga ILD,

Gazetarja Sonila Agostini: Kush mund të jetë institucioni që mund ta bëjë këtë sipas mendimit tuaj?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani: Besoj që Kuvendi është organi më legjitim për ta bërë këtë.

Gazetarja Sonila Agostini: Zoti Metani faleminderit për këtë intervistë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani: Faleminderit edhe juve.

TETOR 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.


© ILD

**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko](#) për të ndjekur spotin prezantues të ILD